



## **Hulumtim i anëtarëve të Platformës së Organizatave Qytetare për Luftë kundër Korrupsionit**

### **Mars, 2020**

Ky dokument është prodhuar nga ekip i Platformës së Organizatave Qytetare për Luftë kundër Korrupsionit me mbështetjen e popullit Amerikan përmes Agjencionit për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID). Pikëpamjet e autorëve të shprehura në këtë publikim nuk reflektojnë medoemos pikëpamjet e Agjencionit për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

## Përmbajtja

1. Perceptime, besim dhe kapitali social: Në çfarë mënyre të thyhet rrotulla e korrupsionit.....	3
2. Mungesa e monitorimit si gjenerues i korrupsionit në ndërmarrjet shtetërore .....	4
3. Transparenca në financimin e partive politike .....	5
4. Rezultate nga monitorimi i ekonomisë së fshehur në Maqedoninë e Veriut në vitin 2018 me theks mbi korrupsionin .....	6
5. Përdorimi i bazave të mëdha me të dhëna si vegla në luftë kundër korrupsionit .....	7
6. Shëndetësia dhe korrupsioni.....	8
7. Përgatitja për luftë kundër korrupsionit nga këndvështrimi i plotësimit të kushteve të parashtruara nga BE-ja..	9
8. Punë e përgjegjshme policore: rreziqet nga korrupsioni në Ministrinë e Punëve të Brendshme .....	10
9. Sekuestrimi i pronës në procedurat gjyqësore lidhur me korrupsionin .....	11
10. Profilimi i korrupsionit të ultë a ka ndonjë grup të caktuar që është më i cenuar nga korrupsioni? .....	12

## 1. Perceptime, besim dhe kapitali social: Në çfarë mënyre të thyhet rrotulla e korrupsionit

*Autorë: Misha Popoviq dhe Simona Mlladenovska, Instituti për Demokraci "Societas Civilis"*

Problemi kryesor për avancimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut paraqet korrupsioni. Përcaktimi më i shpeshtë është se korrupsioni është një keqpërdorim i pozitës për të plotësuar një interes privat. Në këtë mënyrë, në shumë fusha të jetës shoqërore, interesi privat në vend të atij publik, merr përparësinë.

Në këtë mënyrë, aktorët e ndryshëm në këto fusha kanë qëndrime të pabarabartë. Andaj, në fushën ekonomike, disa firma fitojnë status preferues gjatë prokurimeve publike, dhe grupe të lobimit sigurojnë pozitë më të mirë për bizneset e tyre në dëmin e konkurrencës. Punëdhënësit mund të blejnë besnikërinë e institucioneve që do të kthejnë kokën gjatë shkeljeve të vogla të të drejtave të punëtorëve. Punësimet partiake mundësojnë pozitë të pabarabartë të kandidatëve, në dëm të cilësisë. Këshillat komunal dhe kryetarët e komunave mund të jenë nën ndikimin e sektorit ndërtimor dhe të mundësojnë urbanizim pa plan në barrë të mjedisit jetësor dhe standardeve për shtëpi. Efekti më i lartë i këtyre ndikimeve korruptuese janë institucione të dobët që në ciklin e këtyre ndikimeve kanë problem të vazhdueshëm që të kundërshtohen. Ky ri-prodhim i gjendjes krijon një mjedis në të cilën qytetarët mësojnë se korrupsioni është rregull, dhe respektimi i ligjeve është përjashtim. Në këtë mënyrë, arrihet tek perceptimi i shpërndarjes së korrupsionit. Në kohën e njëjtë, të bindur në përfshirjen e institucioneve në problemin, qytetarët humbin besimin.

Qëllimi i analizës është të prezantohen disa dimensione të mendimit publik lidhur me korrupsionin. Në fillim, në tekstin bëjmë në analizë të formulimit të "pritjeve të ndara" për rregullat që lëvizin shoqërinë. Më tutje, debatojmë rreth burimit të tyre – a janë të formuar si vlerë ose përvojë. I analizojmë edhe perceptimet për korrupsion dhe besimin në institucionet. Analizën e përfundojmë me debat rreth efektit mbi kapitalin social. Në fund, ofrojmë konkluzione të shkurta dhe drejtime për institucionet kryesore për mënyrën e veprimit në luftën kundër korrupsionit në kontest të mendimit publik dhe praktikës shoqërore.

Zbulimet tregojnë një gjendje pesimiste të enëve të lidhura. Përvoja e qytetarëve është përvoja e padrejtësisë e krijuar nga institucionet e korruptuara. Ajo thëllon perceptimin e përhapur për paraqitjen e korrupsionit dhe ushqen mosbesimin në institucionet. Në këto kushte, kur rregullat e njohura zëvendësohen me rregulla të heshtura, qytetarët hyjnë në garë të panevojshme për përkatësi në grupe me status për të siguruar edhe gjëra elementare. Në këtë mënyrë qendrat e këtyre grupeve të statusit përfitojnë fuqi të paligjshme dhe nxitje për të mirëmbajtur korrupsionin. Ajo vazhdon ciklin e kësaj përvoje të qytetarëve.

Ulja faktike e korrupsionit në fillim çdoherë do të shoqërohet me uljen e barabartë të ngadalësuar të perceptimit për korrupsionin dhe përmirësim të besimit në institucionet. Ky zhgënjim i qytetarëve nuk duhet të shkurajojnë institucionet që janë në frontin e luftës kundër korrupsionit, si për shembull, Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit. Në qendrën e këtij procesi është përvoja afatgjate dhe përshtypja e themeluar për shmangie të ndëshkimit, dhe kjo sjellje e qytetarëve mund të parashikohet dhe duhet të kuptohet.

Pikërisht për këtë, intervenimi kryesor i institucioneve duhet të drejtohet drejt demonstrimit të qartë që “rregullat e lojës” kanë ndryshuar. Ajo nuk mund të jetë një deklaratë e thjeshtë e pushtetit, por në mënyrë të prekshme të dëshmohet qytetarëve me anë të rasteve në të cilat politikanë me profil të lartë do të japin përgjegjësi konkrete. Vetëm në këtë mënyrë mund të dëshmohet që mënyra e vjetër e drejtimit është ndryshuar me të ri.

Të gjithë analizën mund të lexoni në lidhjen më poshtë:

<http://antikorupcija.mk/mk/record.php?id=1163&mv=4>

## 2. Mungesa e monitorimit si gjenerues i korrupsionit në ndërmarrjet shtetërore

*Autor: Sabina Fakiq, Qendra për Komunikime Qytetare*

“Ndërmarrjet në pronësi shtetërore janë veçanërisht të prekshëm ndaj korrupsionit duke marrë parasysh afërsinë e tyre me pushtetin dhe politikanët, vëllimin e mjeteve me të cilat drejtojnë dhe nivelin kritik të shërbimeve të cilat ofrojnë”, vlerësohet nga ana e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim OECD dhe hulumtimet e tyre tregojnë që në përmasa botërore pikërisht të punësuarit në ndërmarrjet shtetërore më shpesh marrin rryshfet.

Duke marrë parasysh madhësinë e kapitalit të cilën e kanë në dispozicion këto ndërmarrje, si dhe rreziku i rritur nga korrupsioni, në ata imponohet nevoja për monitorimin më të ngushtë lidhur me monitorimin e punës së tyre. Kjo gjendje është veçanërisht i theksuar në vendin tonë sepse ndërmarrjet shtetërore, duke marrë parasysh kapitalin të cilën kanë në dispozicion dhe numrin e të punësuarve, paraqesin burim të fuqisë së madhe ekonomike dhe politike të strukturave në pushtet gjegjësisht partive në pushtet. Gjatë kësaj, kjo fuqi me lehtësi mund të keqpërdoret në kushte të institucioneve të dobëta dhe jofunksionale të sistemit, siç edhe është gjendja në këtë vend.

Qëllimi i këtij dokumenti është që të bëhet vlerësim nëse dhe në çfarë mase opinioni dhe institucionet kompetente monitorojnë punën e ndërmarrjeve shtetërore në vend. Gjatë kësaj, fokusi do të vendoset në dy aspekte të rëndësishme të monitorimit. I pari, monitorimi nga opinioni me anë të transparencës më aktive dhe reaktive të ndërmarrjeve në pronësi shtetërore. Aspekti i dytë ka të bëjë me monitorimin e institucioneve kompetente si Enti Shtetëror për Revizion (ESHR) dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK). Në lidhje me ESHR do të prezantohen të dhëna për kontrollet që janë zbatuar nga ana e revizorëve shtetëror në periudhën 2004 – 2018. Ndërsa, nga ana tjetër, në lidhje me KSHPK do të bëhet një pasqyrë e lëndëve të hapura nga ky organ gjatë 10 viteve të fundit në bazë të analizës së raporteve vjetore të institucionit.

Zbulimet dhe të dhënat e theksuar do të përmbliidhen për të dhënë kontribut për zbardhjen e gjendjeve në një fushë që deri më tani nuk ka qenë mjaft e analizuar në opinion dhe do të mundësojë që të përcaktohen rekomandime të qarta për themeluesit e ndërmarrjeve në pronësi shtetërore si dhe gjithë institucionet kompetente dhe palëve të interesuara.

Rëndësia e këtij dokumenti del nga mungesa e monitorimit mbi punën e ndërmarrjeve publike që jo vetëm mundëson por edhe stimulon korrupsionin në të cilën edhe janë të ndjeshëm këto ndërmarrje shtetërore.

Të gjithë analizën mund të lexoni në lidhjen më poshtë:

<http://antikorupcija.mk/mk/record.php?id=1160&mv=4>

### 3. Transparenca në financimin e partive politike

*Autor: Darko Crvenkovski, Instituti OHËR*

Ky hulumtim paraqet një tentim për identifikim të dobësive të sistemeve ligjore të katër shteteve ballkanike në pjesën e financimit të partive politike. Gjatë kësaj, bëhet hartim i transparencës së partive politike dhe autoriteteve kompetente, gjegjësisht publikimi publik i dokumenteve lidhur me financimin e partive në përputhje me ligjin. Zbulimet dhe konkluzionet nga hulumtimi bazohen në tre komponentë: 1) analizë krahasuese e zgjidhjeve ligjore të katër shteteve ballkanike, përfshirë edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut, Republikën e Serbisë, Republikën e Kroacisë dhe Republikën e Bullgarisë, 2) analiza e gatishmërisë publike të dokumenteve për financim të partive politike dhe 3) të dhënat e mbledhura nga anketa e zbatuar në teren dhe internet me 105 të anketuar.

Hulumtimi i zbatuar është ndarë në tre pjesë. Në pjesën e parë, hulumtimi përqendrohet në zgjidhjet ligjore për financim të partive politike të katër shteteve ballkanike me theks në Maqedoninë e Veriut, gjatë së cilës hartohen ngjashmëritë dhe dallimet e kornizave ligjore në sajë të këtyre shteteve. Qëllimi i dytë i pjesës së dytë nga ky hulumtim është të bëhet një analizë e plotë e transparencës së partive politike dhe autoriteteve shtetërore me anë të analizës së gatishmërisë publike të dokumenteve për financim të partive në Maqedoninë e Veriut. Pjesa e tretë e hulumtimit pasqyron njohjen e opinionit të përgjithshëm me mënyrat në të cilat financohen partitë politike, por edhe dispozitat ligjore që rregullohen këtë materie, përfshirë edhe të drejtat të cilat qytetarët i gëzojnë në përputhje me Ligjin për Financim të Partive Politike.

Pas analizës së zbatuar ishin marrë disa konkluzione. Studimi tregon për disa lloje të pengesave të ndërlidhura që ulin transparencën në pjesën e financimit të partive politike, edhe atë: 1) mungesa e gatishmërisë së raporteve financiare dhe të dhënave nga regjistrat për donacione për opinionin, 2) mungesa e kornizës ligjore për financimin e partive që mundëson korrupsion, 3) shkelja e dispozitave ligjore nga Ligji për Financim të Partive Politike në pjesën e publikimit transparent dhe publik të dokumenteve për financim, dhe 4) perceptimi i opinionit që partitë politike janë të korruptuar. Në bazë të zbulimeve, studimi përfshin edhe disa rekomandime për aktorët e ndryshëm shoqëror dhe relevant nga fusha e financimit të partive politike.

Të gjithë analizën mund të lexoni në lidhjen më poshtë:

<http://antikorupcija.mk/mk/record.php?id=1161&mv=4>

#### 4. Rezultate nga monitorimi i ekonomisë së fshehur në Maqedoninë e Veriut në vitin 2018 me theks mbi korrupsionin

*Autorë: Kristijan Aleksovski dhe Kristijan Trajkoski, Qendra për Hulumtim dhe Krijim të Politikave*

Korrupsioni paraqet një dukuri shoqërore që në mënyrë negative pasqyrohet mbi mirëqenien e gjithë qytetarëve, dhe njëherë konsiderohet forma më e rëndë e cenimit të demokracisë dhe sundimit të së drejtës. Për dallim nga veprimet e përgjithshme kriminele dhe aktivitetet e paligjshme, ndalimi i korrupsionit me anë të zbulimit, inkriminimit dhe kundërvajtjes, paraqet një proces të ndërlikuar, kryesisht për arsye që është vështirë të zhvillohen mekanizma të fuqishme dhe të qëndrueshme kur ata duhet të ndalojnë korrupsionin, gjegjësisht vetë janë të korruptuar. Për shkak të natyrës së ndërlikuar, secili qytetar ka obligim ligjor dhe moral që të luftojë kundër korrupsionit, ajo do të thotë që jo vetëm se nuk duhet të praktikojë veprime korruptive, por duhet edhe të paraqet raste të korrupsionit nëse i identifikon.

Prej pak para, në fokusin e hulumtimit është lidhja e korrupsionit dhe ekonomia joformale. Në fakt, shpesh parashtrohet pyetja nëse ka velim të rritur të korrupsionit në një shoqëri a do të ketë edhe zbatim të aktiviteteve ekonomike në kuadër të ekonomisë joformale dhe anasjelltas. Në kontekst të kësaj çështjeje është zbatuar edhe analiza nga ana e Qendrës për Hulumtim dhe Krijim të Politikave (QHKP) të gjendjes në Maqedoninë e Veriut, dhe qëllimi i dokumentit të hartuar është që me anë të një monitorimi të caktuar në nivel të ekonomisë joformale dhe trendit gjatë viteve të fundit të miratojnë rekomandime që do të kontribuojnë në luftën kundër kësaj dukurie, dhe kjo në mënyrë indikative, edhe në luftën kundër korrupsionit.

Analiza e QHPK-së ka treguar që në Maqedoninë e Veriut, si vend në zhvillim në të cilin ende ndihen pasoja e tranzicionit ekonomik-shoqëror, korrupsioni dhe ekonomia gri janë të ndërlidhura dhe plotësuese. Qytetarët konsiderojnë që rryshfeti është një sjellje që tolerohet në shtet, ndërsa ekonomia gri paraqet një pjesë e pashmangshme e përditshmërisë së tyre. Vendi nuk ka shënuar ndonjë përparim të dukshëm në kuptim të përmirësimit të luftës kundër korrupsionit dhe në periudhën e fundit, edhe pas ndryshimit të pushtetit, keqpërdorim i pozitës zyrtare dhe fuqisë vazhdon të praktikohet. Korrupsioni mbetet një problem kryesor që prish besimin në institucionet, dhe si pasojë, qytetarët kanë më pak besim në gjithë sistemin dhe shpesh mendojnë që nuk janë në pozitë të njëjtë me ata që janë të privilegjuar për të "blerë" përparësinë e tyre. Kjo i nxit që të "kalojnë rrotull" normave juridike me qëllim që të realizojnë dobi më të madhe personale nga aktivitetet ekonomike, jashtë evidencës dhe kontrollit të institucioneve publike.

Nga kjo, duhet që sistemit të përforcojë përpjekjet për të eliminuar edhe ekonominë joformale dhe korrupsionin edhe atë me anë të koordinimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit mes ministrive kryesor edhe institucioneve kompetente nga fusha. Problemi mbetet pavarësisht nga ndryshimi i pushtetit, andaj duhet që të krijohen zgjidhje afatgjatë, dhe jo masa popullore. Aleatë të rëndësishëm të institucioneve shtetërore në zgjidhje të problemeve mund të jenë organizatat qytetare dhe partnerë social, të cilët mund të bashkëpunojnë në ngritjen e shkrim/leximit joformal, gjegjësisht trajnime për

njohje të qytetarëve dhe përfaqësuesit e biznesit me praktikën e mirë dhe të keqe ekonomike, për të ngritur vetëdijen e obligimeve të tyre në shoqërinë.

Të gjithë analizën mund të lexoni në lidhjen më poshtë:

<http://antikorupcija.mk/mk/record.php?id=1162&mv=4>

## 5. Përdorimi i bazave të mëdha me të dhëna si vegla në luftë kundër korrupsionit

*Autor: German Fillkov, Qendra për Komunikime Qytetare*

Me zhvillimin e teknologjisë digjitale mbetet edhe pa ndarë pjesa e jetës dhe punës, ashtu edhe bazat e mëdha me të dhëna me të cilat disponojnë vendet (posaçërisht administrata publike) bëhen e mirë publike kryesore për përforcimin e përpjekjeve kundër korrupsionit. Nga njëra anë, bëhet fjalë për publikim më aktiv në format të hapur të dhënave me kohë, të sakta dhe cilësore, dhe nga ana tjetër përdorimi, përpunimi dhe analiza e këtyre të dhënave për rritjen e integritetit dhe llogaridhënies së sektorit publik. Analiza e bazave të mëdha të e të dhënave mund të mundësojë të arrihen në këtë informacione në të cilat, njeriu, pa zbatimin e këtij mjeti, thjeshtë nuk mund asnjëherë të arrijë.

Në mënyrën e njëjtë që këto baza mbushen me shpejtësi të madhe, ashtu do të rriten edhe mundësitë e tyre për luftë kundër korrupsionit. Në të njëjtën kohë do të rriten edhe sfidat – kryesisht me drejtimin e bazave, mbrojtjen e të dhënave personale, gjetjen dhe mbajtjen e personave profesional për punë me bazat dhe analiza e të dhënave, etj.

Ky dokument për politika publike paraqet konceptin e përdorimit të bazave të mëdha të dhënave në luftë kundër korrupsionit, mënyrën e zbatimit, anët pozitive dhe sfidat, si dhe hapat fillestare dhe rekomandimet për përshejtim të përdorimit të këtij mjeti në luftën kundër korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Mosnjohja e potencialit dhe roli i mundshëm i lartë i bazave të mëdha të dhënave në përpjekjet kundër korrupsionit sjell në disa investime të vogla në këtë fushë dhe mungesa e marrjes parasysh të këtij roli në strategjitë kundër korrupsionit. Por, për të përdorur bazat e mëdha të të dhënave në qëllime kundër korrupsionit, duhet përforcim i kapaciteteve njerëzore në institucionet që kryejnë këtë punë, në kuptim të sigurimit të nivelit të mjaftueshëm të njohurisë informatike dhe pajisjeve.

Ndonëse zbatimi i plotë i analizës së bazave të mëdha me të dhëna për qëllime kundër korrupsionit ende pritët, gjithkund të botë, në Evropë, nëpër Indi, SHBA dhe Kore, ka shumë shembuj të suksesshëm për parandalimin e korrupsionit me anë të mundësimin të bazave të mëdha digjitale me të dhëna të "leoxjnë2 atë që nuk mund të bëjë njeriut me pajisjen e thjeshtë me të cilën punon çdo ditë.

Nga ana tjetër, tek ne, duket që duhet një vullnet më i rëndësishëm politik, posaçërisht në pragun e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave 2020-2024. Në këtë drejtim duhet të përshejtohet dhe të shpeshtohet procesi i digjitalizimit të shërbimeve, vendosja në dispozicion gjitha bazat më të mëdha me të dhëna dhe lidhja e tyre. Sektori publik duhet të

gjejë mënyrë për ekipim të kuadrove me persona përkatës profesional për punë me baza të mëdha me të dhëna dhe analizë të këtyre të dhënave. Gjithsesi, këtu përfshihet edhe bashkëpunimi dhe bashkëveprimi edhe me sektorin afarist.

Të gjithë analizën mund të lexoni në lidhjen më poshtë:

<http://antikorupcija.mk/mk/record.php?id=1173&mv=4>

## 6. Shëndetësia dhe korrupsioni

*Autor: Darko Crvenkovski, Instituti OHËR*

Qëllimi kryesor i hulumtimit është të identifikohet niveli i korrupsionit në shëndetësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Me këtë hulumtim synohet korrupsioni në shëndetësi në nivelin mikro, korrupsioni që zhvillohet në kontaktin e përditshëm të pacientit dhe familjes së tij me të punësuarit në institucionet publike shëndetësore. Zbulimet dhe konkluzionet nga hulumtimi bazohen në tre komponentë: 1) analizë krahasuese e ligjeve për mbrojtje shëndetësore në pjesën e korrupsionit në katër shtetet e Ballkanit, përfshirë edhe Republikën e Maqedonisë së Veriut, Republikën e Serbisë, Republikën e Kroacisë dhe Republikën e Bullgarisë, 2) analizë e studimeve të rastit të korrupsionit në shëndetësinë, dhe 3) të dhëna të mbledhura nga anketa e zbatuar në internet me 207 të anketuar.

Hulumtimi i zbatuar është ndarë në tre pjesë. Në pjesën e parë, hulumtimi përqendrohet në analizë të sistemeve ligjore për mbrojtje shëndetësore të katër shteteve ballkanike, gjatë së cilës hartohen dobësitë dhe anët pozitive në kornizat ligjore të këtyre shteteve në pjesën e përballimit me korrupsionin në shëndetësi. Një theks i veçantë është vendosur në zhvillimin e kornizave ligjore për mbrojtje shëndetësore si dhe perceptimet e ndryshme të korrupsionit në sisteme të ndryshme juridike.

Pjesa e dytë e hulumtimit është analizë e tre studimeve të rasteve të korrupsionit në shëndetësi në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Bëhet fjalë për raste të korrupsionit të vogël në nivel të ultë me të cilët bëhet analizë e perceptimeve të qytetarëve në shtet për këtë lloj të korrupsionit dhe pranimi i tyre si një lloj norme shoqërore. Gjithashtu, analizohen dhe identifikohen arsyet kryesore për ndodhjen e korrupsionit dhe përse ky rast nuk denoncohet tek organet kompetente.

Pjesa e tretë e hulumtimit përqendrohet në përpunimin sasior dhe cilësor i të dhënave nga anketa e zbatuar në internet me të cilën analizohen përvojat dhe perceptimet e qytetarëve dhe opinionit më të gjerë për nivelin e korrupsionit në shëndetësi, përhapja e kësaj dukurie dhe pranimi i korrupsionit në shëndetësi si normë e përgjithshme sociale. Hulumtimi analizon njohjen e qytetarëve me dispozitat ligjore për korrupsion në shëndetësi me identifikimin e arsyeve për paraqiten e korrupsionit.

Hulumtimi arrin në disa konkluzione të rëndësishme: 1) përqindja e korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut është mjaft më e ulët nga përqindja e korrupsionit në vendet e BE-së, por në krahasim me përqindjen e numrit më të madh të vendeve të Ballkanit, 2) perceptimet e qytetarëve për



korrupsion në shëndetësi janë më të mëdha nga përqindja e korrupsionit të vërtetë në shëndetësi, 3) vendet që janë bërë anëtare të Bashkimit Evropian shënojnë një përparim të dukshëm në luftën kundër korrupsionit në shëndetësi, 4) dhënia e shpërblimit është normë e pranuar sociale në përgjithësi në Maqedoninë e Veriut, 5) korrupsioni ekziston edhe në institucionet private shëndetësore.

Të gjithë analizën mund të lexoni në lidhjen më poshtë:

<http://antikorupcija.mk/mk/record.php?id=1174&mv=4>

## 7. Përgatitja për luftë kundër korrupsionit nga këndvështrimi i plotësimit të kushteve të parashtruara nga BE-ja

*Autorë: Jasmina Ristovska dhe Natasha Ivanovska, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar*

Ky dokument i politikave publike përqendrohet në karakteristikat kryesore dhe tendencat e politikave për luftë kundër korrupsionit që përmbahen në Kapitullin 23 në kontekst të politikës së kushtëzimit të BE-së, si dhe gjendja dhe përparimi i Maqedonisë së Veriut në rrugën drejt BE-së. Në këtë drejtim, në dokumentin analizohet ndikimi i politikës së kushtëzimit me anë të vlerësimit të reformave në politikat kundër korrupsionit dhe shkalla e plotësimit të rekomandimeve dhe vërejtjeve nga ana e vendit. Megjithatë, për të fituar një pasqyrë të plotë të gjendjes me korrupsionin dhe përputhjen me politikat e BE-së, janë shqyrtuar edhe disa indekse që në nivelin global matin korrupsionin dhe efikasitetin e shteteve për të përballuar këtë dukuri.

Dokumenti për politika publike tregon që ndonëse dëshira për t'u bërë pjesë e Unionit është një stimul i rëndësishëm për të bërë reforma, sërish korrupsioni edhe më tutje mbetet të jetë një problem serioz dhe është i pranishëm në shumë fusha. Kjo situatë sqarohet me institucionet aktuale të dobët dhe të politizuar, niveli i kulturës demokratike dhe toleranca e korrupsionit nga gjithë qytetarët, si dhe mungesa e vullnetit politik për ndryshime. Ndonëse ka një kornizë të mirë juridike dhe institucionale, sërish nuk ka rezultate konkrete, dhe mungon edhe vullneti politik për ndryshime të rëndësishme.

Nuk ka dyshim të BE-ja ka një ndikim potencial të lartë mbi Maqedoninë e Veriut që fillimisht është për shkak të përpjekjeve dhe pohimeve të secilës qeveri që anëtarësimi në BE është prioritet i parë i jashtëm politik. Në çdo rast, ajo që mund të përfundohet nga dokumenti është se BE-ja jo çdoherë i përdor mekanizmat që i ka në dispozicion në mënyrë efektive, si nga faktorë të brendshëm/kufizime të Unionit, ashtu edhe nga rezistenca e vendit për të pranuar kushtet në masën e nevojshme. Nëse BE-ja dëshiron transformim politik, duhet që të ofrohen shpërblime dhe kërcënime të besueshme, gjegjësisht BE-ja duhet të ofrojë anëtarësi Maqedonisë së Veriut në kohën më të shkurtë për të avancuar demokracia dhe efektiviteti në luftën kundër korrupsionit.

Rekomandimet që i japin autorët janë në drejtim të zbatimit pro aktiv të rregullave të reja për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, dhe ri-afirmim të vullnetit politik për luftë kundër korrupsionit me anë të mbështetjes së gjithë institucioneve relevante me autonominë e nevojshme dhe

sigurimin e resurseve të nevojshme njerëzore dhe financiare. Institucionet duhet të konsolidojnë evidencën për aktgjykimet e fundit në lëndë të korrupsionit në nivel të lartë, përfshirë edhe me sekuestrimin e pronës së përfituar në mënyrë të paligjshme, dhe gjithsesi duhet të sigurohet përgjegjësi ligjore që bisedat e përgjuara të vazhdojë pavarësisht me reformat aktuale në kuadër të sistemit të prokurorisë.

Për rezultate në afatin e gjatë duhet avancim edhe në teren dhe investim i përpjekjeve në gjitha nivelet dhe nga gjitha palët e interesuara (pushteti, opozita, sektori qytetar dhe afarist) dhe gjithsesi dedikim nga BE-ja. Por, atë që gjithsesi duhet të keni në mend është se reformat duhet të bëjmë, kryesisht, për vetë avancim të demokracisë dhe jetës më të mirë, jo vetëm për të marrë dritë jeshile nga BE-ja. Qeveria dhe gjithë palët e interesuar duhet të vazhdojnë në drejtimin e reformave duke u udhëhequr nga prioritetet shtetërore.

Të gjithë analizën mund të lexoni në lidhjen më poshtë:

<http://antikorupcija.mk/mk/record.php?id=1175&mv=4>

## 8. Punë e përgjegjshme policore: rreziqet nga korrupsioni në Ministrinë e Punëve të Brendshme

*Autorë: Dr. Kire Babanoski dhe M-r Liljana Pecova Ilieska, Transparencë – Maqedoni*

Policia është organi kompetent shtetëror për zbatimin e ligjit, për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave njerëzore, mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e rendit dhe paqes publike dhe zbulimi i krimit dhe ndjekja e kryerësve. Gjatë kryerjes së këtyre detyrave dhe kompetencave, nëpunësit policor nuk guxojnë të përdorin autorizimet zyrtare për të ftuar dobi të caktuar në shoqëri për qëllime private.

Koncepti “korrupsion në punën policore” përfshin çdo shkelje të procedurave dhe hapave standarde, keqpërdorime të detyrës zyrtare ose tejkalim i autorizimeve policore për dobi të drejtë ose jo, të premtuar, ofruar, dhënë, kërkuar ose pranuar ose pritje materiale dhe jo materiale ose ndonjë interes tjetër i nëpunësit policor, për vete ose për ndonjë tjetër.

Qëllimi i këtij punimi është të identifikohen rreziqe potenciale nga paraqitja dhe prania e sjelljeve korruptuese në Polici – Ministrinë e Punëve të brendshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Prandaj, në fillim, në mënyrë të shkurtë dhe transparente, pasqyrohen rezultatet, zbulimet dhe konkluzionet e hulumtimeve të deritanishme nga kjo fushë, analizohen llojet e përgjegjësive të punës policore (penale, ndëshkimore, materiale dhe disiplinore), arsyetohet nevoja për punë të përgjegjshme policore, dhe për analizë më të plotë të lëndës së vendosur, edhe një kornizë hipotetike, si dhe shqyrtim i perceptimeve të opinionit shkencor dhe profesional, janë zbatuar edhe disa intervista me tetë pyetje të llojit ët hapur, në të cilat kërkohet sqarim të përgjigjeve.

Nga hulumtimi ishte përcaktuar që sfida kryesore e Ministrisë së Punëve të Brendshme në lidhje me luftën kundër korrupsionit është zbulimi i vonshëm dhe identifikimi i rreziqeve nga korrupsioni, si dhe

zbulimi i vonshëm, sqarimi, dokumentimi dhe dëshmimi i sjelljeve korruptuese në të cilat kanë qenë të përfshirë nëpunës policor. Nëpunësit policor nuk guxojnë të përdorin autorizimet zyrtare për të ftuar dobi të caktuar në shoqëri për qëllime private. Ata çdoherë duhet të respektojnë standardet e punës profesionale, të posedojnë nivel të lartë të integritetit, të kenë ndjenjë të zhvilluar të rezistencës ndaj rryshfetit, integritetit, vetëdijes së përforcuar, vetë-kritikë si dhe vazhdimisht të zhvillojnë njohuritë e tyre për të drejtat e njeriut dhe etika e profesionit policor.

Për ulje të numrit të veprimeve joprofesionale të nëpunësve policor si dhe ulja e tyre në minimum, duhet në veçanti të ndërmerren masa të caktuara parandaluese që në fazën e rekrutimit të nëpunësve policor. Në këtë kuptim, duhet të mbahet llogari për integritetin e personave që hyjnë në shërbimin e MPB, me anë të kontrolleve të veçanta në fazën e përzgjedhjes. Gjatë edukimit të tyre, duhet edhe trajnim për veprim profesional, rezistencë dhe integritet, në përputhje me dispozitat ligjore lokale. Gjatë punës së tyre, duhet të zbatohen trajnime plotësuese të veçanta dhe seminare, për zhvillimin e vazhdueshëm në veprimin policor. Në fund, secili nëpunës policor duhet të mësojë mirë Kodin e Etikës Policore, dhe të respektojë mirë dispozitat, si dhe të kujdeset për sjelljen personale profesionale dhe dinjioze. Vendosja e kontrolleve funksionale dhe mekanizmave vëzhguese që do të kontrollojnë punën e nëpunësve policor, do të rezultojë dukshëm në lidhje me transparencën dhe hapjen ndaj qytetarëve dhe institucioneve shtetërore. Gjithashtu, preferohet që të vendoset edhe një mekanizëm i jashtëm ose autoritet që do të monitorojë vlerësimin e Kodit për Etikë Policore, me çfarë do të ketë funksion të autoritet vetë-rregullues në kuadër të krijimit dhe respektimit të standardeve profesionale.

Për luftë efikase kundër korrupsionit në polici, gjithashtu të rëndësishëm janë edhe vullneti politik, zgjidhjet normative, korniza institucionale, zbatimi efikas i ligjeve, kapaciteti institucional dhe personal dhe integriteti, funksionaliteti i shërbimit publik dhe prokurorisë dhe pushtetit gjyqësor, si dhe bashkëpunimi me gjithë institucionet e interesuara në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar.

Të gjithë analizën mund të lexoni në lidhjen më poshtë:

<http://antikorupcija.mk/mk/record.php?id=1176&mv=4>

## 9. Sekuestrimi i pronës në procedurat gjyqësore lidhur me korrupsionin

*Autorë: Darko Avramovski dhe Natali Petrovska, Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë"*

Sekuestrimi i pronës është një masë e veçantë juridike që në teori dhe në praktikë theksohet si një mjet efikas për luftën kundër krimit dhe korrupsionit të motivuar ekonomik, dhe për këtë përfitohet me popullaritet të lartë dhe promovim intensiv dhe ri-afirmim, posaçërisht në fund të shekullit të fundit. Efikasiteti i sekuestrimit të pronës është e njohur edhe në nivelin ndërkombëtar, dhe për këtë shumë autoritete ndërkombëtare kanë miratuar dokumente që kanë të bëjnë me promovimin e sekuestrimit dhe motivim të kornizave ligjore kombëtare që të dedikohen për gjallërimin e serishëm dhe përdorimin në luftën kundër pronës së përfituar në mënyrë të paligjshme dhe krimin e motivuar financiar. Qëllimi i këtij dokumenti është të jep një pasqyrë të strukturës ligjore të sekuestrimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të jep një shqyrtim të zhvillimit në ligjet vendore, si dhe të përcaktojë gjendjet lidhur me zbatimin praktik të sekuestrimit të pronës, posaçërisht me procedurat penale lidhur me

korrupsionin e lartë. Në këtë mënyrë, do të nënvizohen dobësitë e rregullores ligjore, do të përcaktohet frekuenca e përdorimit të sekuestrimit, do të zbulohen vështirësitë me të cilat përballohen institucionet gjatë zbatimit praktik të kësaj mase, dhe do të jepen edhe rekomandime për tejkalimin e problemeve të identifikuara, si në ligjet, ashtu edhe gjatë zbatimit.

Ka disa terme të ndryshme që përdoren në mënyrë të ndërsjellë, dhe kanë të bëjnë me sekuestrimin e pronës, marrjen e përkohshme të gjërave për sigurim, si dhe marrja e gjërave me të cilat është kryer vepra penale. Përveç kësaj, mund të hasen edhe dallime në terminologjinë e përdorur në ligje të ndryshme, dhe janë ato ligje që në një mënyrë rregullojnë masën e sekuestrimit. Për këtë arsye, duhet që të bëhet një unifikim i terminologjisë së përdorur, si dhe të bëhet kufizim i drejtë i sekuestrimit dhe marrjes së gjërave që janë të synuar për kryerjen e veprës penale ose që dalin nga vepra penale.

Dispozitat e Kodit Penal që kanë të bëjnë me sekuestrimin janë të përgjithshme dhe paqartë, posaçërisht në kuptim të sekuestrimit të marrë ndaj personave të tretë, ose zbatimi i sekuestrimit të gjerë, dhe për këtë duhet të bëhet një revizion i këtyre dispozitave.

Dispozitat për sekuestrim të pronës nga Ligji për Procedurë Penale nuk janë të harmonizuar me modelin e ri adversial të procedurës penale të prezantuar në vetë LPP në vitin 2010. Përveç kësaj, këto dispozita nuk janë të qarta dhe lejojnë vend të lirë, posaçërisht në kuptim të drejtave të personave të tretë gjatë gjithë procedurës penale, mënyrat e realizimit të drejtave të tyre, si dhe zgjidhja e problemit me veprimin e dyfishtë të këtyre personave si dëshmitarë në procedurën.

Dispozitat e procedurës për sekuestrim jashtë procedurës penale (kur e njëjta nuk mund të nisët për shkak të pengesave ligjore ose faktike) nuk janë të plotë dhe duhet zberthimi i tyre dhe rregullimi i hollësishëm gjatë procedurës.

Sekuestrimi i pronës nuk shqiptohet shpesh nga ana e gjykatësve, madje edhe në numrin e kufizuar të rasteve, institucioneve kompetente mbledhin pak informacione për zbatimin e sekuestrimit, dhe jo shpesh metodologjia e mbledhjes dhe përpunimit të dhënave dallohet varësisht nga institucioni, për shkak edhe paraqiten dallime në të dhënave, por jo edhe pengesa për kryqëzimin e të dhënave.

Duhet të mundësohet vëzhgim i vazhdueshëm i zbatimit të sekuestrimit, masat për marrjen e përkohshme të gjërave, si dhe cilësia e hetimeve financiare, posaçërisht në lëndët nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsioni.

Të gjithë analizën mund të lexoni në lidhjen më poshtë:

<http://antikorupcija.mk/mk/record.php?id=1178&mv=4>

## 10. Profilimi i korrupsionit të ultë a ka ndonjë grup të caktuar që është më i cenuar nga korrupsioni?

*Autor: Misha Popoviq, Instituti për Demokraci "Societas Civilis"*

Korrupsioni në Republikën e Maqedonisë së Veriut është një fenomen i përhapur gjerë. Përveç korrupsionit në nivelin më të lartë, qytetarët shpesh janë të ekspozuar në korrupsion në kushte kur

duhet të marrin një shërbim të caktuar publik. Andaj, për të fituar një shërbim të caktuar, qytetarëve ju kërkohet dhuratë, shërbim për kthim ose ryshfet. Ajo ju ndodh në shumë institucione publike si komunë, spitale, ministri, polici dhe fusha tjera të sektorit publik.

Në hulumtimet dhe aktivizimin kundër korrupsionit, sërish duhet të dimë nëse ka grup i caktuar i qytetarëve që janë më tepër të nënshtruar korrupsionit. Në fillim, duhet të hulumtojmë nëse qytetarët me orientime të caktuara të vlerave janë më afër që të jenë lëndë e korrupsionit. Ajo do të ndihmojë që të shohim nëse qytetarët përshtatin shikimin e tyre në bazë të ekspozimit të tyre në korrupsion.

Dimensionin e dytë që duhet të hulumtojmë është nëse ka grup të caktuar social-ekonomik që është më tepër e ekspozuar në korrupsion. Ajo jep një mundësi që të shikojmë se cili është përpjesëtimi i shtypjes nga korrupsioni me kapitalin ekonomik dhe social me të cilin qytetarët kanë në dispozicion.

Për këtë qëllim, ky dokument analizon të dhënat e hulumtimit të mendimit publik me mostër kombëtare përfaqësuese prej 1000 të anketuarve, të zbatuar në janar të vitit 2019. Metoda e parë e analizës me shumë variante të korrespondencave që siguron analizë të shpejtë të lidhjeve të pjesëve ndryshuese cilësore. Metoda e dytë është analiza me ndarje hierarkike, që siguron grupim të anketuarve sipas përgjigjeve që kanë dhënë.

Analiza e të dhënave tregon që në Maqedoninë e Veriut vështirë mund të profilohej të anketuarit sipas ekspozimit në korrupsion. Arsyeja kryesore për këtë është përhapja e gjerë e ekspozimit në korrupsion (11% nga të gjithë të anketuarit), që do të thotë se në këtë pjesë mund të gjejmë kategori të ndryshme.

Ndonëse ka këto lloje të kufizimeve, hulumtimi ka dëshmuar që posedimi i resurseve ekonomike dhe sociale ndërlidhet me ekspozimin e korrupsionit. Në shoqërinë tonë, të ardhurat dhe njohuritë sociale janë edhe synim i ndikimit korruptues, dhe nga kjo, edhe gjasat që lehtë të mund të transformohen në transaksione korruptuese. Në fillim, flasim për eksploatimin e rrjeteve të njohurisë me anë të cilave shkëmbehen shërbime, që është mënyra më dominuese e transaksioneve korruptuese në vend.

Nga ana tjetër, kombinim i vlerave, besimit dhe perceptimit për sjellje korruptuese në masë të vogël ndërlidhet me ekspozimin në korrupsion. Në këtë kuptim, mund të themi që ata të cilët mendojnë më pak që korrupsioni është përhapur, ose nuk e njohim, në masë të vogël kanë paraqitur ekspozim në korrupsion. Nga kjo, ekspozimi në korrupsion nuk është gjendje specifike karakteristike për një grup të caktuar të vlerës.

Të gjithë analizën mund të lexoni në lidhjen më poshtë:

<http://www.antikorupcija.mk/mk/record.php?id=1187&mv=4>